

VENDIM
Nr. 8, datë 9.4.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME ERSEKË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Ersekë me:
Drejtues ligjor: z. Robert Kita
Drejtues teknik: z. Vangjel Gjergo
2. Operatori sh.a. UK Ersekë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse, të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Ersekë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 8.4.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi